



Datë: 26.02.2025
Numër Protokolli: 1761/2025

A.nr.93/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, si dhe Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.93/2025, të datës 14.01.2025, të parashtruar nga ankuesja V.M, kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.93/2025, e datës 14.01.2025, e parashtruar nga ankuesja V.M.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 14-11701-165798/24, i datës 23.12.2024, i Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civil V.M (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 14.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 14-11701-165798/24, të datës 23.12.2024, të Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës, për shkak të shkeljeve të Ligjit për Pagat ne Sektorin Publik, Vendimit me Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe shkeljeve thelbësore të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.02.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit më datë 12.02.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 159/2025 të datës 14.01.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 14-11701-165798/24, të datës 23.12.2024, të Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës; Vendimin me Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së

Kosovës; Akt Emërimit të datës 01.02.2017; Akt Emërimit të datës 16.11.2024; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.01.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 12.02.2025; Kërkesën të datës 17.12.2024 të ankueses për Sektorin e Burimeve Njerëzore; Diplomën me Nr.2157 të datës 06.10.2009 për ankuesen.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 16.11.2024, mban pozitën e punës *Zyrtar i Lartë i Tatimit në Pronë*, në Komunën e Prishtinës me koeficient të pagës GJ25, 5.7.

Tutje sipas shkresave të lëndës, ankuesja më datë 17.12.2024 ka parashtruar kërkesë tek Sektori i Burimeve Njerëzore i Komunës së Prishtinës, për sistemimin në pozitën e Specialistit me koeficient në GJ9, 6.6. Menaxheri i Personelit në Komunën e Prishtinës, më datë 23.12.2024 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 14-11701-165798/24, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankueses.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 14-11701-165798/24, të datës 23.12.2024, të Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës, pretendon se gabimisht nuk është përfshirë në kuadër të pozitave të specialistëve ngase plotëson të gjitha kushtet e parapara të përfshira në kuadër të kësaj kategorie sepse është nga përshkrimi i detyrave të punës por edhe nga kërkesat e përgjithshme formale pozita që mbaj kategorizohet në kuadër të kategorisë së specialistëve me koeficient GJ9, 6.6. Kërkon që të aprovet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të obligohet Komuna e Prishtinës që të miratoj ekuivalencën e koeficientit për të punësuarin në GJ9, koeficienti 6.6, dhe të bëjë kompensimin e diferencës së pagës nga muaji janar 2023 me kamat prej 8%.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, fillimisht konstaton faktin se sipas Akt Emërimit të datës 16.11.2024, ankuesja e mban pozitën e punës *Zyrtar i Lartë i Tatimit në Pronë*, në Komunën e Prishtinës në kuadër të kategorisë profesionale 1, me klasë dhe koeficient të pagës GJ25, 5.7, ndërsa sipas nenit 38 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyratë Publike, është përcaktuar se: “2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. *Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtorin/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtorin/in ekzekutiv dhe zëvendës drejtorin/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.4. **Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional**”, kurse një kategorizim i njëjtë është paraparë edhe sipas nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, mirëpo kjo rregullore me nenin 8 ka përcaktuar se: “*Kategoria e specialistëve është kategoria përgjegjëse për kryerjen e detyrave të veçanta profesionale që kërkojnë përgatitje specifike sipas fushave të përcaktuara në Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje*”, e si rezultat i kësaj sipas Shtojcës Nr.1/4 të kësaj rregulloreje tek përshkrimi për klasën e specialistëve është paraparë: “*Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale. Mbajtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi. Mbajtësit e këtyre pozitave punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave*”, ndërsa në kuadër të kësaj shtojce tek arsimi i kërkuar për pozitat e specialistëve është*

paraparë *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat e inxhinierisë, planifikim hapësinor, arkitekturë, urbanizëm, gjeodezi, kimi, fizikë, matematikë, biologji, mjekësi, farmaci, biokimi, ekologji, pylltari, bujqësi, veterinar, gjeografi, ambient, astronomi, astrofizikë, pa përfshirë drejtimit arsimore.*

Kolegji i Këshillit, për të shqyrtuar tutje pretendimin ankimor dhe duke marr parasysh faktin se ankuesja pozitën sipas akt emërimit e ka Zyrtar i Lartë i Tatimit në Pronë, ju referua edhe katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil i miratuar sipas Vendimit me Nr.08/226 të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku pozita që mban ankuesja hyn në kuadër të grupit të përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave, rrjedhimisht nëse i referohemi këtij grupi që është përcaktuar në kuadër të Shtojcës Nr. 2 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, për grupin e përgjithshëm i tatim-taksave apo mbledhjes së të ardhurave fusha e arsimit/drejtimit kërkohet: *Juridik/ Ekonomi (pavarësisht nga specializimi)*, njëjtë është paraparë edhe me katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil.

Andaj duke marr parasysh konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja për nga përgatitja profesionale është Juriste e Diplomuar, atëherë sipas kritereve të arsimit që kërkohen për kategorinë e Specialistëve, rezulton se ankuesja nuk plotëson kushtet për t'u përfshirë në kuadër të kategorisë së Specialistëve, kështu që kategorizimi i pozitës së ankueses në kuadër të kategorisë profesional 1 në pozitën Zyrtar i Lartë i Tatimit në Pronë është bërë në pajtim me kërkesat ligjore edhe me përgatitjen e tij profesionale, kështu që ankueses në këtë rast nuk i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e saj e punës, ngase paga e ankueses sipas aktit të emërimit është në pajtim të plotë me nenin 13 dhe 14 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Shtojcës Nr. 10.7, sipas numrit rendor 25 tek emërtimi i plotës profesional 1 për Kryeqytetin me koeficient 5.7.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të ligjshmërisë së aktit të kundërshtuar me ankesë, gjegjësisht Vendimit me numër protokolli 14-11701-165798/24, të datës 23.12.2024, të Menaxherit të Personelit të Komunës së Prishtinës, konstaton se ky vendim është nxjerr në pajtim të plotë dispozitat e cekura më lartë të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, depozitat e cekura më lartë dhe shtojcën e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, dispozitave dhe shtojcave të cekura më lartë të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë– Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.93/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankueses, V.M;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*